



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura VIII

Komisioni për Buxhet, Punë dhe Transfere
Mbledhja nr.10/24
Prishtinë, më 15.5.2024, në orën 11:00
Ndërtesa e Kuvendit të Kosovës, Salla C-203

Procesverbal

Në mbledhje morën pjesë: Armend Muja, Mërgim Lushtaku, Enver Haliti, Jeta Statovci, Visar Korenica, Eman Rrahmani dhe Pal Lekaj.

Munguan: Ferat Shala, Avdullah Hoti dhe Duda Balje.

Të ftuar: Luljeta Aliu, anëtarë e bordit, KPM, Fitim Veliu, anëtar i bordit, KPM, Ganimete Nuqi, KPM, Jeton Mehmeti, kryetar bordi, KPM.

Pjesëmarrës të tjerë: Ema Krasniqi, monitoruese, KDI, Valmire Abdullahu, gazetare, EO, Sanije Berisha, OSBE, Nexhmije Ahmeti, zyrtare, Anduena Shtavica, GP LDK, Festim Bytyci, këshilltar, GP AAK, Munib Durguti, asistent, Kuvend, Sami Gashi, GP LVV, Egzona Terdevci, GP LVV, Elsa Krasniqi, GP LVV, Valdet Hadri, Kuvend dhe Jeton Bajraktari, Kuvend.

Stafi mbështetës i Komisionit: Sabrije Saliuki- Iseini, Luljetë Krasniqi dhe Diar Beqaj, praktikant në KBPT.

Mbledhjen e kryesoi Armend Muja, kryetar i Komisionit.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rëndit të ditës;

2. Shqyrtimi i raportit më amendamente i Komisionit FunkSIONAL për Çështjet e Sigurisë dhe Mbrojtjes për Projektligjin nr.08/L-274 për Shërbimet Private të Sigurisë;
3. Shqyrtimi i raportit më amendamente i Komisionit FunkSIONAL për Çështjet e Sigurisë dhe Mbrojtjes për Projektligjin nr.08/L-267 për letërnjoftim;
4. Shqyrtimi i raportit më amendamente i Komisionit FunkSIONAL për Mandate Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit për Projektligjin nr.08/L-256 për Falimentim;
5. Shqyrtimi i raportit më amendamente i Komisionit FunkSIONAL për Çështjet e Sigurisë dhe Mbrojtjes për Projektligjin nr.08/L-225 për Agjencinë e Inteligjencës dhe Sigurisë se Mbrojtjes;
6. Shqyrtimi i Projektligjit nr.08/L-302 për ratifikimin e Marrëveshjes për Projektligjin së Kredisë në mes të Republikës së Kosovës, përfaqësuar nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve dhe Bankës Zhvillimore të Këshillit të Evropës për Projektin “ Banim Social Adekuat”;
7. Shqyrtimi i raportit vjetor financiar i Komisionit të Pavarur për Media për vitin 2023;
8. Shqyrtimi i raportit vjetor financiar i Institucionit të Avokatit të Popullit për vitin 2023;
9. Shqyrtimi i raportit vjetor financiar i Agjencisë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës për vitin 2023;
10. Të ndryshme.

1.Miratimi i rendit të ditës;

Kryetari: Ju njoftoj se ministri i financave z. Hekuran Murati dhe ministri i Infrastrukturës z. Liburn Aliu, me datë 15.5.2024 përmes e-mailit kanë njoftuar se nuk kanë mundësi të marrin pjesë në mbledhje të Komisionit, sepse janë në vizite zyrtare jashtë vendit.

Ministri Murati dhe Aliu kanë qene të ftuar për të arsyetuar (Piken 6) të Projektligjit nr.08/L-302 për ratifikimin e Marrëveshjes për Projektligjin së Kredisë në mes të Republikës së Kosovës, përfaqësuar nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve dhe Bankës Zhvillimore të Këshillit të Evropës për Projektin “ Banim Social Adekuat”.

Po ashtu, edhe nga Zyra e Avokatit të Popullit ka njoftuar se Avokati i Popullit z. Naim Qelaj gjendet në udhëtim zyrtar jashtë vendit dhe nuk ka mundësi të merr pjesë në mbledhje të komisionit për të arsyetuar raportin financiar IAP për vitin 2023.(pika e 8)

Po ashtu, edhe përfaqësuesja e Agjencisë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës, përmes e-mailit ka njoftuar se nuk ka mundësi të marrë pjesë në mbledhje të komisionit për shkak se më 15.5.2024, është në vizitë jashtë vendit.(pika 9)

Kryetari, konstatoi që me shumicë votash, u miratua rendi i ditës, me ndryshime.

2.Shqyrtimi i raportit më amendamente i Komisionit FunkSIONAL për Çështjet e Sigurisë dhe Mbrojtjes për Projektligjin nr.08/L-274 për Shërbimet Private të Sigurisë;

Kryetari: Projektligji nr.08/L-274 për Shërbimet Private të Sigurisë është shqyrtuar nga Komisionit Funkcional për Çështjet e Sigurisë dhe Mbrojtjes dhe komisioni e ka dërguar raportin me amendament.

Departamenti i Buxhetit në Ministrinë e Financave, vlerëson se Projektligji **nr.08/L-274 për Shërbimet Private të Sigurisë**, nuk do të ketë kosto shtesë buxhetore mbi planifikimet buxhetore, të parapara me Ligjin mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës (për vitin 2023 dhe planifikimin për vitin 2024-2025). Të gjitha aktivitetet do të mbulohen nga nënprogrami Shërbimet e Administratës Qendrore, në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme.

Kryetari, konstatoi qe me shumice votash, Komisioni nxori këtë:

R e k o m a n d i m

1. Projektligji nr.08/L-274 për Shërbimet Private të Sigurisë, nuk përmban implikime buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës.
2. Amendamentet e propozuara nga Komisionin Funkcional, për Projektligjin nr.08/L-274 për Shërbimet Private të Sigurisë, nuk përmbajnë implikime buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës.

3. Shqyrtimi i raportit më amendamente i Komisionit Funkcional për Çështjet e Sigurisë dhe Mbrojtjes për Projektligjin nr.08/L-267 për letërnjoftim;

Kryetari: Projektligji nr.08/L-267 për letërnjoftim është shqyrtuar nga Komisionit Funkcional për Çështjet e Sigurisë dhe Mbrojtjes, i cili komisioni ka dërguar raportin me amendamente.

Departamenti i Buxhetit në Ministrinë e Financave, vlerëson se projektligji **Projektligji nr.08/L-267 për letërnjoftim**, nuk do të ketë kosto shtesë buxhetore mbi planifikimet buxhetore të parapara me ligjin mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës (për vitin 2023 dhe planifikimin për vitin 2024-2025). Të gjitha aktivitetet do të mbulohen nga Ministria e Punëve Brendshme konkretisht nënprogramin Agjencia e Regjistrimit Civil, i cili do të zbatohet në praktikë këtë projektligj.

Kryetari, konstatoi qe me shumicë votash, Komisioni nxori këtë:

R e k o m a n d i m

1. Projektligjin nr.08/L-267 për letërnjoftim nuk përmban implikime buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës.
2. Amendamentet e propozuara nga Komisionin Funkcional, për Projektligjin nr.08/L-267 për letërnjoftim, nuk përmbajnë implikime buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës.

4.Shqyrtimi i raportit më amendamente i Komisionit Funkcional për Mandate Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit për Projektligjin nr.08/L-256 për Falimentim;

Kryetari: Projektligji nr.08/L-256 për Falimentim është shqyrtuar nga Komisionit Funkcional për Mandate Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit, i cili komisioni ka dërguar raportin me amendamente.

Departamenti i Buxhetit në Ministrinë e Financave, vlerëson se Projektligji nr.08/L-256 për Falimentim, nuk do të ketë kosto shtesë buxhetore mbi planifikimet buxhetore, të parapara me ligjin mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës (për vitin 2023 dhe planifikimin për vitin 2024-2026). Të gjitha aktivitetet do të mbuloohen nga Ministria e Drejtësisë nënprogrami - Departamenti i Profesioneve të Lira.

Kryetari, konstatoi që me shumicë votash, Komisioni nxori këtë:

R e k o m a n d i m

1. Projektligji nr.08/L-256 për Falimentim nuk përmban implikime buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës.
2. Amendamentet e propozuara nga Komisionin Funkcional, për Projektligji nr.08/L-256 për Falimentim, nuk përmbajnë implikime buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës.

5.Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit Funkcional për Çështjet e Sigurisë dhe Mbrojtjes për Projektligjin nr.08/L-225 për Agjencinë e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes;

Kryetari, në pajtueshmëri me anëtarët e Komisionit, konstatoi që kjo pikë e rendit të ditës shtyhet për mbledhjen e radhës.

6.Shqyrtimi i Projektligjit nr.08/L-302 për ratifikimin e Marrëveshjes për Projektligjin së Kredisë në mes të Republikës së Kosovës, përfaqësuar nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve dhe Bankës Zhvillimore të Këshillit të Evropës për Projektin “ Banim Social Adekuat”;

Kryetari: Ju njoftoj se për këtë pikë kemi diskutuar në mbledhjen e mbajtur më 24 prill dhe 8 maj 2024, por është vendosur që të vazhdojmë diskutimet edhe në mbledhjen e radhës për këtë marrëveshje. Ministri i financave z. Hekuran Murati dhe ministri i Infrastrukturës z. Liburn Aliu, me datë 15.5.2024 përmes e-mailit, kanë njoftuar se nuk kanë mundësi të marrin pjesë në mbledhje të Komisionit, sepse janë në vizite zyrtare jashtë vendit.

Kryetari, e hodhi në votim këtë pikë të Rendit të ditës dhe konstatoi që me shumicë votash, Komisioni nxori këtë:

R e k o m a n d i m

Të miratohet Projektligjin nr.08/L-302 për ratifikimin e Marrëveshjes së Kredisë në mes të Republikës së Kosovës, përfaqësuar nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve dhe Bankës Zhvillimore të Këshillit të Evropës për Projektin “ Banim Social Adekuat.

7.Shqyrtimi i raportit vjetor financiar i Komisionit të Pavarur për Media për vitin 2023

Kryetari: Në bazë të neni 3 paragrafit 2.8. i Ligjit nr. 04/L-44 për Komisionin e Pavarur të Mediave, KPM-ja i paraqet Kuvendit të Republikës së Kosovës, deri më 31 mars të vitit vijues një raport vjetor, duke përfshirë edhe të dhënat e plota në lidhje me përcaktimin dhe zbatimin e politikës së transmetimit, dhënien e licencave dhe të ankesave, sanksionet që zbatohen dhe vendimet në lidhje me to, aktivitetet financiare, aktivitetet e tjera të transmetimit, si dhe objektivat për vitin e ardhshëm. Raporti vjetor duhet të bëhet publik pas miratimit nga ana e Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Komisioni për Buxhet, Punë dhe Transfere është ngarkuar që të shqyrtojë raportin vjetor financiar të KPM-së për vitin 2023 dhe të paraqet raportin me rekomandime për Komisionin funksional.

Lidhur me këtë pikë e kemi ftuar kryesuesin e KPM-së, z. Jeton Mehmetaj, që të prezantojë dhe arsyetojë Raportin financiar të KPM-së për vitin 2023.

Jeton Mehmetaj: Kemi pasur një buxhet total prej 841,956, apo 90% shpenzime të buxhetit, apo 757,465 euro. Nga buxheti i vitit të kaluar vetëm për paga dhe mëditje janë shpenzuar 424,073 euro. Ajo çfarë dua të potencoj është se në vitin që po lëmë pas, kemi pasur të hyra prej 390,000 euro, të hyrat përfshihen të hyrat nga tarifat e licencës, nga tarifat e rilicencimit, nga gjobat dhe kamatat për ato gjoba dhe ajo çfarë dua të potencoj është se kemi pasur një inkasim të borxheve paraprake prej 92 mijë euro. Ne kemi trashëguar një akumulim të borxheve paraprake prej rreth 700,000 euro dhe nga këto kemi arritur me një vendim tonin që t'u mundësojmë subjekteve të licencuara që borxhet paraprake t'i paguajnë me një marrëveshje, të cilën do ta nënshkruan indirekt me KPM-në, apo me përmbaruesin dhe në bazë të asaj marrëveshjeje ato mund të bëjnë pagesën me këstet e borxheve paraprake në afatin prej 12 muajve.

Pal Lekaj: Sa i përket një auditimi të performancës për menaxhimi e licencimeve në Komisionin e Pavarur për Media, duke përfshirë periudhën 2008 - 2022 në raport, përfundim ka nxjerrë që kontrollet e brendshme të KPM-së janë të mangëta, nuk janë të vëmendshme për të përcjellë transmetimin e OB-ve dhe kjo ka rezultuar me vonesa dhe pagesa në trajtimin e rasteve të mospagesës dhe akumulimin e borxhit.

Si ka qëndruar KPM-ja në vitin 2023 në kuptimin e menaxhimit të financave, kontrolleve, rasteve dhe pagesave të OB-ve që i detyrohen KPM-së?

Pse keni rritur shpenzimin në kategorinë paga dhe shtesa?

Në raport keni potencuar që bazuar në mbështetjen e vendimit të Qeverisë, institucionit tuaj u janë tërhequr nga kategoria paga dhe shtesa, shuma monetare me vlerë prej 39,390 euro, a ka ndikuar negativisht në punën dhe funksionimin e institucionit tuaj tërheqja e parë nga Qeveria e Kosovës?

Pse i keni dyfishuar shpenzimet në dreka zyrtare?

Jeton Mehmetaj: Sa i përket pyetjes së parë mbi menaxhimin e financave për vitin 2023, mund të themi sikurse që ka konkluduar dhe raporti i auditimit që transaksionet kanë qenë në harmoni me kërkesat ligjore. Mendimi jonë është që ka qenë një vit i mirë në kuptimin e inkasimit të të hyrave . Të hyrat e përgjithshme pra për vitin 2023 kanë qenë pothuajse në harmoni me planifikimet, vetëm se janë shtuar madje edhe më shumë nga vendimi jonë për vendimin për pagimin e borxheve paraprake.

Sa i përket pyetjes së dytë në paga dhe shtesa, kjo ndërlidhet Ligjin për pagat, i cili ka bërë një rritje substanciale të pagave për anëtarët e komisionit dhe anëtarët e Bordit për ankesa të cilët

janë paraparë aty dhe kjo nënkupton që me automatizëm, pra janë rritur edhe shpenzime sa i përket pagave për stafin e Komisionit të Pavarur për Media.

Sa i përket shpenzimeve për akomodim, ka rritje, kjo mund të ndërlidhet me faktin që për rreth tetë muaj kemi qenë pa kuorum, pra pa vendimmarrje si komision sepse në vitin 2022, ju ka skaduar mandati disa anëtarëve, Komisioni nuk ka arritur që të ndërmarrë ndonjë aktivitet.

Kjo mund të jetë një prej arsyeve, pse ka një rritje sa i përket pjesës akomodimit.

Shpenzimet për mobilie dhe mirëmbajtje, këtu hyjnë edhe shpenzime të cilat kanë të bëjnë për mirëmbajtjen e sistemit të monitorimit, KPM-ja ka një sistem pothuajse të avancuar të monitorimit të mediave, i cili çdo vit duhet të paguhet mirëmbajtja.

Jeta Statovci: Po filloj me këtë shqetësimin në raport me shpenzimet e udhëtimeve, po në qoftë se shkon edhe te tabela e faturave të papaguara, pra prapë pesë fatura janë lidhje me shpenzimet e udhëtimit për anëtarin e bordit, Besnik Berisha, i cili ka shpenzime te udhëtimit të papaguara në muajin 9 dhe 11. Pra, këtu jemi duke iu referua vetëm faturave të papaguara. Do te ishte e rrugës që me na përcjellë edhe një listë të shpenzimeve të udhëtimit të personalizuar, që të shohim se ku është frekuenca dhe cilat janë arsyet.

Jeton Mehmetaj: Ndoshta të ishte ma e udhës, ashtu siç edhe e kërkuat që t'ju ofrojmë një listë të detajuar për shpenzimet zyrtare edhe për drekat, Njëra prej atyre drekave, të cilat e përmendët, ka të bëjë me drekën të cilën kemi pasur me donatorë, të cilën për herë të parë në historinë tonë kemi organizuar takim koordinues me donatorë dhe kemi pa të udhës që pas takimi, të shkojmë për një drekë zyrtare.

Mergim Lushtaku: Sa i përket pjesës së raportimit, ju e thatë që keni realizua 90% të buxhetit total, ndërsa këtu është 85%, nëse e keni buxhetin e planifikuar, pse atëherë Qeveria e Kosovës iu ka marr shumë prej 39,000 euro për shkak të mosshfrytëzimit të mjeteve në kategorinë në paga dhe mëditje.

Në raport pash që shumë biznese, shumë televizione, nuk kanë pagua me vite të tëra borxhet e tyre ndaj KPM-së, cilat janë veprimet e juaja konkrete?

Jeton Mehmetaj: në javën e kaluar kemi marrë një draft-raport nga Zyra Kombëtare e Auditimit, sa i përket auditimit të financave dhe aty ju referova kur thashë që në fakt është konstatimi i tyre që thotë se në vitin 2023, KPM-ja ka shpenzuar 90% të buxhetit final me një arritje prej 2% krahasuar me shpenzimet e vitit paraprak. Ndërkaq sa i përket pyetjes mbi këtë shumën që është tërhequr nga Qeveria e Kosovës, në vendimin e Qeverisë, aty shihen shumë institucione të cilave u janë tërhequr, por mund të supozoj se arsyeja është për këtë tepriçë nuk kemi arritur t'i shpenzojmë të gjithë mjetet. Në korrik të vitit të kaluar, kemi marrë një vendim në të cilin i kërkojmë të gjitha subjekteve të licencuara që kanë borxhe, që të hyjnë në marrëveshje për pagesë me këste dhe RTK-së ia kemi sqaruar këtë.

Kam pasur takim zyrtar domethënë në RTK, ku e kam shpjeguar politikën tonë të pastaj edhe në aspektin e financave kolegët tanë nga Financat janë takuar me kolegë nga RTK-ja, fillimisht për t'u dakorduar dhe për të hequr të gjitha dilemat mbi borxhin që e kanë. Dhe, kur thamë RTK-ja, kam fjalën për katër televizione dhe dy radio publike dhe secili prej tyre ka një tarifë ndryshe, për shembull RTK dy, në fakt tre dhe katër, që janë vetëm me kabllorë, tarifën e kanë shumë më të ulët sesa RTK-ja që është, e që e mbulon gjithë gjithë vendin.

Mergim Lushtaku: A keni marrëveshje konkrete me një përmbarues të caktuar dhe pyetje tjetër është Forma se si institucioni KPM-ja e ka përzgjedhë marrëveshjen me përmbaruesin.

Jeton Mehmetaj: Ne vitin e kaluar si Komision i ri e kemi thirrur për të raportuar përmbaruesin, kompania e të cilit e ka marrë këtë detyrë që nga 2014 kur ka hy në fuqi, pra Ligji për përmbarimin dhe absolutisht nuk kemi qenë të kënaqur me performancën e tij. Ne kemi takuar së bashku me kolegë, të kemi pyetur për këto, na kanë dhënë arsye të ndryshme, mungesa e lokacionit, mungesa e një qasjeje të re që e ka quajtur, si për shembull parashtrimi i lëndëve pa arsye të ndryshme e të tjera, na ka dhënë shumë arsye dhe pastaj kemi vendosur që të ecim tutje me vendimin tonë, ku u kemi kërkuar palëve, ndoshta më mirë është pas një marrëveshje direkt me KPM-në, sesa përmes përmbaruesve, kjo në kuadër të vullnetit të mirë për t'i paguar borxhet paraprake.

Luljeta Aliu: Dua të ndërlihem me pyetjen për masat që i kemi ndërmarrë për përmirësimin e inkasimit të borxheve. Sigurisht se kjo do të ketë një ndikim pozitiv këto rezultatet e para veçse i kemi marrë, përndryshe masa tjera që i kemi ndërmarrë është krijimi i nënkomisionit për inkasimin e borxheve, ka qenë kërkesë që e kam shtrua në komision që të ndahen punët në nënkomisione, që secili anëtar ta marrë përsipër një prej fushave ose vështirësive me të cilat përballet KPM-ja. Tani kemi Nënkomisionin për Inkasimin e Borxheve, pastaj për të Drejtën e Autorit për ndryshimin e pronësisë edhe për frekuencat. Dua të them, që përpos të gjitha vështirësive, mangësive, ndoshta neglizhencës që mund të ketë në lidhje me inkasimin e borxheve, një pjesë e kësaj vështirësie është edhe kjo pika e gjykatës. Meqë atë ankohen në gjykatë, nuk e bëjnë pagesën as të faturës domethënë të licencës edhe kur gjykata vendos në favor të tyre, pastaj kjo është për neve problematike.

Enver Haliti: Zyra Kombëtare e Auditimit kanë gjetur që ka pasur vonesa në vendimmarrje për ripërtëritjen e licencave. A është kjo si rrjedhojë e vitit 2022 apo ka ndodhë edhe në vitin 2023, për të cilin ju po raportoni dhe desha ta di se si është situata sot? A keni vonesa në ripërtëritjen e licencave, përtej afatit që është i përcaktuar me ligj, do të thotë brenda afatit tridhjetë ditor, ku siç e thashë Zyra Kombëtare e Auditimit nga 15 mostra të analizuara, kanë gjetur që në 8 prej tyre ka pasur vonesa deri në një vit. Pse keni zvogëlim të pagesave të qirasë, keni ndërrua lokacion apo si e shpjegoni këtë?

Jeton Mehmetaj: Sa i përket pyetjes së dytë, kemi bërë një kërkesë tek personi fizik, ku e kemi objektin me qira, që të bëhet një zbritje e qirasë. Prej nëntorit 2022, është zvogëluar kjo shumë. Po presim që shumë shpejt të hapet objekti, i cili është ndërtuar enkas për KPM-në, mirëpo ka disa vonesa finale, kështu që përfundimisht po bëhet një zgjidhje e mirë në këtë në këtë drejtim. Ndërkaq, sa i përket e pyetjes së parë, vonesa në vendimmarrjen në përtëritjen e licencave për vitin 2023, edhe të ketë, për shkak se ne kemi marrë një vendim tjetër, në momentin që bëhet një kërkesë për ripërtëritje të licencës. Kemi sanksionuar me gjobë të gjitha këto raste dhe pastaj të gjitha këta persona duhet të bëjnë pagesën e borxheve para se të vijë lënda në ri trajtim, për t'iu vazhduar ose jo licenca.

Visar Korenica: Në këtë moment kur po flasim, sa është borxhi total, a kemi ulje apo kemi rritje të borxhit? A ka apo nuk ka obligime RTK-ja në këto tre vitet e fundit, ashtu qysh ju e deklaruat pak më parë?

Jeton Mehmetaj: Deri më 1 qershor kanë për obligim t'i paguajnë tarifën e licencës të gjitha mediat. Kurse RTK-ja, dy vitet e fundit ka qenë korrekte në pagesën e tarifës së licencës, borxhi të cilin e përmenda ma herët prej rreth 250,000 euro, pra është borxh i cili i përket një periudhe të kaluar dhe kjo i ka tri dimensione: njëra është pra tarifa e licencës, tjetra janë gjobat që janë sanksionua për RTK-në dhe e treta mund të jetë kamata nga vonesa për mospagesën.

Kryetari: Ku është çështja e licencimit të RTK-së dhe cili ka qenë vendimi?

Jeton Mehmetaj: Na është dashur t'i qëndrojmë besnik vendimit tonë, të cilën kemi thënë se asnjë subjekt i cili ka borxhe paraprake dhe nuk hyn në marrëveshje, nuk do t'i vazhdohet licenca.

Kryetari: Edhe RTK-ja aktualisht është pa licencë?

Jeton Mehmetaj: Jo të gjitha televizionet e RTK-së, por, një pjesë e mirë janë pa licencë.

Visar Korenica: Nëse ju nuk krijoni mekanizëm të brendshëm, detyrues për ta, për me i pagua borxhet, kurrë nuk do ti paguajnë.

Do të tërhiqen licencat, nëse nuk kryhen pagesat paraprake.

E juaja është me nxjerrë mekanizëm ligjor i cili i detyron ata me i krye borxhet.

Përndryshe, ne nuk kemi se si ta aprovojmë raportin tuaj, se kemi përgjegjësi publike ndaj qytetarëve të Kosovës. Ju keni përgjegjësi mbi supet tuaja, një obligim që e keni marrë, jeni zotuar kur e keni marrë mandatin që keni me i përdorë të gjithë mekanizmat që janë në dispozicion, për me realizua inkasimin e obligimeve.

I jepni një përgjigje këtij Komisioni, këtyre anëtarëve të Komisionit, qysh do t'i inkasoni borxhet?

Jeton Mehmetaj: Në vitin 2024, do të jemi zero zero me borxhet.

Kryetari: Sa është fatura e borxhit të RTK-se dhe na dërgoni neve Komisionit, faturën ?

Visar Korenica: A mund t'na dërgoni një plan qysh ju e parashihni uljen e borxhit deri në fund të vitit, në kuadër të këtij Komisioni që keni formuar?

Jeton Mehmetaj: Po.

Kryetari: Në raportin vjetor thuhet që KPM-ja ka pasur një takim me përfaqësuesit e Zyrës së BE-së. Në atë takim, mes tjerash, morën pjesë të gjithë anëtarët, dhe u diskutua për sfidat e KPMM-së, fillimisht për vështirësitë financiare, si pasojë e shkurtimeve buxhetore, unë e mora buxhetin e KPM-së dhe mua nuk po më del që ka pasur shkurtime, po më del që ka pasur rritje. Tek pagat po ashtu, ka pasur rritje dhe kjo deklaratë me përfaqësuesit e BE-se, është e pavërtetë. Duhet ta korrektoni ose e argumentoni disi.

Jeton Mehmetaj: Mbase mënyra se si është formuluar deklarata, nuk është e sqaruar si duhet.

Kryetari: A do ta zbatoni legjislacionin primar dhe sekondar në raport me të gjitha aspektet e licencimit që nga tarifa e të tjera, të ndryshimit të pronësisë. A mund ta kemi si përkushtim që do të zbatohet ligji?

Jeton Mehmetaj: Gjithsesi.

Kryetari, konstatoi që raporti i KPM-së për vitin 2023, do të miratohet pas pranimit të raportit të Auditimit nga ZKA-ja.

8. Të ndryshme.

Nuk pati ndonjë çështje për diskutim.

Mbledhja përfundoi në orën 14:30.

E përgatiti: Staffi mbështetës i Komisionit.

Armend Muja,

Kryetar i Komisionit